

Emri i Lëndës : Metoda Kërkimore							
Kodi	Tipi	Semestri	Leksione (orë/javë)	Seminare (orë/javë)	Lab (orë/javë)	Kredite	ECTS
LAW 401	A	Vjeshtë	4.00	0.00	0.00	4.00	6.00
Lektori		Ada Güven, PhD					
Asistenti							
Gjuha e kursit		Shqip					
Niveli i lëndës		Master					
Përshkrimi		LAW 401 synon të paisë studentët, të cilët kanë njohuri në shkencat sociale, me aftësi për të kuptuar se si duhet ndërmarrë një kërkim në këtë fushë dhe çfarë përfshin kërkimi në shkencat sociale. Kursi është projektuar që të ekspozojë një informacion të përgjithshëm të metodave kërkimore që përdoren në kërkimin bashkëkohor social. Law 401 do të përgatisë studentët për të zhvilluar më tej aftësitë e tyre kërkuese nëpërmjet shqyrtimit të hollësishëm të koncepteve bazë dhe teknikave që përdoren në kërkimin shkencor në fushën sociale. Kursi si i tërë i dedikohet elementeve të kërimit social të cilat përfshijnë: formulimi i koncepteve dhe teorive; hartimi i pyetjeve kërkimore; mbledhja e të dhënave; analiza e të dhënave; rishikimi i literaturës; dhe shkrimi i konkluzioneve. Për më tepër, ne do të konsiderojmë përdorimin praktik të kërimit në fushën e ligjit dhe do të shqyrtojmë etikën e kërimit në fushën sociale. Qëllimi kryesor i kursit është që të përgatisë studentët, të cilët fillojnë karrierën në fushën e ligjit, me njohuritë bazë për të kryer kërkim shkencor për aspekte ligjore dhe jo ligjore. Gjatë zhvillimit të kursit do të analizohet një ese, me 2000 fjalë, dhe do t'i jepet përgjigje e detajuar pyetjeve të tilla si: • është ky një shëmbull i një eseje të zhvilluar mjaftueshëm në fushën e ligjit? • është ky një shëmbull i shkëlqyer për një ese në fushën e ligjit? Në fund të simestrit studentët do të jenë në gjendje të dallojnë burimet primare dhe burimet sekondare, të përdorin me efektivitet teknika të ndryshme të kërimit, dhe të zhvillojnë më tej aftësitë për kërkim shkencor në fushën sociale. Kursi do t'i ndihmojë studentët në hartimin e propozimeve kërkimore duke synuar në përgatitjen e tyre për procesin e disertacionit.					
Objektivat		Kursi projektohet për të arritur objektivat e mëposhtme: • Së pari, të zhvillojë tek studentët njohuritë bazë se si të kryejnë, me kapacitetin e tyre, një kërkim shkencor. • Së dyti, të zhvillojë tek studentët teknika dhe strategji efektive për kërkimin në fushën e ligjit. • Së treti, të zhvillojë tek studentët aftësinë e të gjykuarit se si të zgjedhin dhe vlersojnë metoda të ndryshme kërkimore. • Së katërti, të zotërojnë kompetencë të mjaftueshme (a) për të lexuar në mënyrë kritike një ese kërkimore (b) për të vlersuar në mënyrë kritike punimet shkencore (c) për të vlersuar cilësisht punimet në fushën e ligjit që ekspozohen në media. Së fundmi, të zhvillojë tek studentët aftësinë për të punuar në ekip gjatë kërimit shkencor.					
Konceptet Kryesore		1. Metoda Kërkimore 2. Kërkimi sasior 3. Kërkimi Cilësor 4. Pyetja Kërkimore 5. Hipoteza 6. Rishikimi i literaturës 7. Metoda IRAC 8. Referencat					
Programi i Lëndës							
Java		Tema					
1		Prezantimi i silabusit. Hyrje në kërkimin shkencor					
2		Metodat e kërimit social. Cilat janë dy tipologjitë kryesore të kërimit? Një veshtrim i përgjithshëm mbi shkencën dhe kërkimin shkencor. Qëllimi i kërimit shkencor. Pse kërkimi shkencor është tejet i rëndësishëm? Kategoritë e kërimit shkencor. Essentials of Research Design and Methodology ff 1-15. Social Research Methods, ff 1-8.					
3		Strategjitë e kërimit shkencor. Kërkimi cilësor dhe sasior. Disa konsiderate epistemologjike. Etika dhe politika në kërkimin shkencor. Social Research Methods, ff 18-42, The Practise of Social Research ff 1-88.					

4	Dizenjimi i kërkimit shkencor: Planifikimi dhe projektimi i nje kerkimi shkencor. Rendesia e koncepteve operacionale. Metodot e dizenjimit: dizenjimi eksperimental, cross-sectional, i shtrire ne kohe, studimi i rastit dhe dizenjimi ikrahasuar. Social Research Methods, ff 44-75. The Practise of Social Research ff 89-159. Essentials of Research Design and Methodology, ff 27-64.
5	Dizenjimi i kërkimit shkencor: Elementet e kerkimit shkencore ne shkencat sociale. Rishikimi i literatures, formulimi i pyetjeve kerkimore, llojet e pyetjeve kerkimore, mbledhja dhe analiza e te dhenave. Interpretimi i gjetjeve dhe hartimi i konkluzioneve. Essentials of Research Design and Methodology, ff 95-123, 198-233.
6	Planifikimi, formulimi i pyetjes kerkimore dhe rishikimi i literaturës I Social Research Methods, ff 79-95. Mjeshteria e hulumtimit, ff 40-76
7	Planifikimi, formulimi i pyetjes kerkimore dhe rishikimi i literaturës II Social Research Methods, ff 97-128. Mjeshteria e hulumtimit, ff 40-76
8	Mid – Term Exam
9	Shkrimi akademik ligjor dhe studimi i rasteve (2). Ne shume aspekte shkrimi akademik ne fushen e ligjit eshte i ngjashem me shkrimin akademik ne disiplina te tjera. Por, ne do te analizojme disa karakteristka specifike vetem per shkrimin akademik ne fushen e ligjit. Me tej, ne kete leksion ne do te trajtojmë disa modele punimesh akademike ne fushen e ligjit (punime akademike me 2000 fjale) te cilat jane perzgjedhur si punime te shkelqyera, mesatare dhe te dobta. Analiza e modeleve do na beje te kuptojme diferencat e nje punimi akademik ne fushen e ligjit qe eshte i shkelqyer, mesatar dhe i dobët. Materialet per kete leksion do te merren nga Shkolla e Ligjit e Melburnit: https://law.unimelb.edu.au/
10	Shkrimi akademik ligjor dhe studimi i rasteve (1). Ne shume aspekte shkrimi akademik ne fushen e ligjit eshte i ngjashem me shkrimin akademik ne disiplina te tjera. Por, ne do te analizojme disa karakteristka specifike vetem per shkrimin akademik ne fushen e ligjit. Me tej, ne kete leksion ne do te trajtojmë disa modele punimesh akademike ne fushen e ligjit (punime akademike me 2000 fjale) te cilat jane perzgjedhur si punime te shkelqyera, mesatare dhe te dobta. Analiza e modeleve do na beje te kuptojme diferencat e nje punimi akademik ne fushen e ligjit qe eshte i shkelqyer, mesatar dhe i dobët. Materialet per kete leksion do te merren nga Shkolla e Ligjit e Melburnit: https://law.unimelb.edu.au/
11	Si të lexosh një punim shkencor dhe si te perdoresh ne menyre te zgjuar internetin. The Practise of Social Research ff 506-521
12	Kërkimi në fushën e ligjit dhe teknikat e kerkimit ne fushen e ligjit. Kerkimi ne fushen e ligjit. Informacioni tek: http://www.csas.ed.ac.uk/_data/assets/pdf_file/0005/66542/Legal_Research_Chynoweth_-_Salford_Uni..pdf
13	Metodat e kërkimit në internet dhe konsideratat etike gjate kerkimit ne internet. Social Research Methods, ff 653-683.
14	Perfshirja e burimeve dhe sit e ruhesh nga plagjatura e paqellimte. Referencat (Chicago dhe OSCOLA) Mjeshteria e Hulumtimit, ff 238-254.
15	Rishikim i realizimit të objektivave të kursit
16	Provim Final

Parakushtet	Studenti duhet të frekuentojë lëndën në masën minimale prej 75%.
Literatura	• Eugene Volokh, Academic Legal Writing: Law Review Articles, Student Notes, Seminar Papers, and Getting on Law Review (4 edition, Foundation Press 2010) • Edward P. Bailey and Philip A. Powell, The Practical Writer with Readings (7th Edition, Thomson Wadsworth 2008) • Earl R. Babbie, The Practice of Social Research (12th Edition, Cengage Learning 2012) • Alan Bryman, Social Research Methods (4th Edition, OUP 2012)
Referenca të tjera	• Oxford University Standard for the Citation of Legal Authorities (OSCOLA) <https://www.law.ox.ac.uk/sites/files/oxlaw/oscola_4th_edn_hart_2012.pdf> accessed 1 September 2015 • Geoffrey Marczyk, David De Matteo, and David Festinger. Essentials of Research Design and Methodology. John Wiley & Sons, Inc. (2005). • Wayne C. Booth, Gregory G. Colomb, Joseph M. Williams, Joseph Bizup, William T. Fitzgerald. Mjeshteria e Hulumtimit (si të shkruash thjesht dhe qarte). Perktheu Neritan Sejmini. Shtepia e Botimit Papirus (2016). • http://www.csas.ed.ac.uk/_data/assets/pdf_file/0005/66542/Legal_Research_Chynoweth_-_Salford_Uni..pdf
Rezultatet e Lëndës dhe Kompetencat	
1	Kursi ka si qëllim që të zhvillojë më tej njohuritë dhe aftësitë e studentëve lidhur me metodat e kerkimit social me një fokus më të përqëndruar në kërkimin në fushën e ligjit. Me përfundimin me sukses të kursit studentët mastër do jenë në gjëndje që të zotërojnë një përjasje të përfjithshme lidhur me procesin e kerkimit në fushën sociale
2	Kursi ka si qëllim që të zhvillojë më tej njohuritë dhe aftësitë e studentëve lidhur me metodat e kerkimit social me një fokus më të përqëndruar në kërkimin në fushën e ligjit. Me përfundimin me sukses të kursit studentët mastër do jenë në gjëndje që të zotërojnë njohuri të avancuara lidhur me metodat e kerkimit në fushën sociale dhe më specifikisht për kërkimin në fushën e ligjit
3	Kursi ka si qëllim që të zhvillojë më tej njohuritë dhe aftësitë e studentëve lidhur me metodat e kerkimit social me një fokus më të përqëndruar në kërkimin në fushën e ligjit. Me përfundimin me sukses të kursit studentët mastër do jenë në gjëndje që të kontrollojnë qartësisht pyetjen kërkimore dhe të kryejnë rishikimin e literaturës
4	Kursi ka si qëllim që të zhvillojë më tej njohuritë dhe aftësitë e studentëve lidhur me metodat e kerkimit social me një fokus më të përqëndruar në kërkimin në fushën e ligjit. Me përfundimin me sukses të kursit studentët mastër do jenë në gjëndje që të dallojnë qartësisht metodat sasiore dhe cilesore të kerkimit
5	Kursi ka si qëllim që të zhvillojë më tej njohuritë dhe aftësitë e studentëve lidhur me metodat e kerkimit social me një fokus më të përqëndruar në kërkimin në fushën e ligjit. Me përfundimin me sukses të kursit studentët mastër do jenë në gjëndje që të konstruktojnë një plan kërkimor
6	Kursi ka si qëllim që të zhvillojë më tej njohuritë dhe aftësitë e studentëve lidhur me metodat e kerkimit social me një fokus më të përqëndruar në kërkimin në fushën e ligjit. Me përfundimin me sukses të kursit studentët mastër do jenë në gjëndje që të zotërojnë mënyrat e përdorimit të citimeve dhe aftesi pr për të shkruajtur disertacionin

Mënyra e Vlerësimit të Lëndës			
Notat e Ndërmjetme	Sasia	Përqindja	
Gjysmë finale	1	40	
Kuize	0	0	
Projekte	0	0	
Projekte semestrale	0	0	
Punë laborator	0	0	
Pjesëmarrja në mësim	0	0	
Kontributi i notave të ndërmjetme mbi vlerësimin final			40
Kontributi i provimit final mbi vlerësimin final			60
Total			100
Ngarkesa ECTS (Në Bazë të Ngarkesës së Studentit)			
Aktivitetet	Sasia	Kohëzgjatja (orë)	Ngarkesa Totale (orë)
Kohëzgjatja e kursit (Duke përfshirë edhe javën e provimeve : 16x Orët totale të kursit)	16	4	64
Orët e studimit jashtë klase (Parapërgatitje, Praktika etj)	14	2	28
Detyra	0	0	0
Gjysmë finale	1	20	20
Provimi final	1	30	30
Të tjera	0	0	0
Ngarkesa totale e orëve			142
Ngarkesa totale e orëve / 25 (orë)			5.68
ECTS			6.00